

UDHËZIM
Nr. 7, datë 30.4.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 30.6.2023, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË NJËVLERSHMËRISË
SË DËFTESAVE DHE DIPLOMAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR, TË ARDHUR NGA JASHTË VENDIT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 52, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 13, datë 30.6.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar, të ardhur nga jashtë vendit”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) shkronja “b” e pikës 2 të kreut III, shfuqizohet.
- b) shkronjat “b” dhe “c” të pikës 2 të kreut IV, shfuqizohen.
- c) shtojca nr. 3, “Tabela e konvertimit të notave të shkollës”, zëvendësohet me shtojcën nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Politikave të Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Komisioni i Njohjes së Dëftesave dhe Komisioni i Njohjes së Diplomave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA NR. 3
TABELA E KONVERTIMIT TË NOTAVE TË SHKOLLËS

Shteti	Klasat	Notat						
Shqipëria	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Greqia	1 - 4	4.00-4.90		5.00-6.4	9	6.50-7.49	7.50-8.49	8.50-10.00
	5-6	4.00-4.90	5	6	7	8	9	10
	7-12	7-9	10	11-12	13-14	15-16	17-18	19-20
Kosova	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Mali i Zi	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Maqedonia e Veriut	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Serbia	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Bosnja dhe Hercegovina	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Çekia	1-12	5	-	4	3	2	-	1
Sllovakia	1-12	5	-	4	3	2	-	1
Rusia	1-12	1	-	2	3	-	4	5
Kroacia	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Sllovenia	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Italia	1-13	5	-	6	7	8	9	10
Turqia	1-12	25-44	45-49	50-54	55-61	62-69	70-84	85-100
Gjermania	1-12	6	5	4	-	3	2	1
Austria	1-13	6	5	4	-	3	2	1
SHBA	1-12	F	E	D	-	C	B	A
Mbretëria e Bashkuar	1-12	F	E	D	-	C	B	A
Irlanda	1-12	7-8	6	5	4	3	2	1
Bullgaria	1-12	2	-	3	-	4	5	6
Polonia	1-12	1	-	2	3	4	5	6
Rumania	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Franca	1-12	9.99	-	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	18.00-20.00
Belgjika	1-12	9.99	-	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	18.00-20.00
Luksemburgu	1-12	1-29	-	30-35	36-39	40-47	48-51	52-60
Zvicra	1-12	2-3	-	4	-	5	-	6

Norvegija	1-12	1	-	2	3	4	5	6
Holanda	1-12	1-5	-	6	7	8	9	10
Finlanda	1-12	1	2	3	4	5	6	7
Suedia	1-12	F	-	E	D	C	B	A
Spanja	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Danimarka	1-12	1.99	-	2-3.99	4-6.99	-	7-9.99	10-12
Estonia	1-12	0	1	2	3	4	-	5
Hungaria	1-12	1	-	2	3	4	-	5
Letonia	1-12	1-3	4	5	6	7	8	9-10
Lituania	1-12	1-4	5	6	7	8	9	10
Portugalia	1-12	0-9	-	10	11-13	14-17	-	18-20
Egipti	1-12	0-49	-	50-64	65-74	-	75-84	85-100